

LEDIA DUSHKU

**SHQIPTARËT PËRBALLË USHTARAKËVE
DHE DIPLOMATËVE AUSTRO-HUNGAREZË
(1914-1916)**

“I përçarë në fise të panumërta që luftojnë njëri-tjetrin, me nivel kulturor shumë të ulët ... i përtuar për punë ..., i ashtuquajtur popull shqiptar është ... elementi pothuajse më i pabesueshëm i Gadishullit të Ballkanit ... Mungesa e çdo ideje për bashkim e ka kthyer Shqipërinë ... në një teatër të influencave të ndryshme të huaja dhe i ka dhënë një fund të shpejtë dhe jo heroik ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar të porsakrijuar.

Shqipëria nën protektoratin tonë do të mbetet për Monarkinë një rrezik i përhershëm, që do të gëlltisë shuma kolosale në të holla dhe, më pas, shumë shpejt do të bëhet viktimë e luftërave të brendshme dhe plaçkë e fqinjëve.

... Në mendimin tim në këtë vend kufitar, vetëm me anë të një sundimi efektiv në këto zona të përkrahura me vështirësi, me një edukim të fortë dhe konsekuent për rregull dhe disiplinë të këtyre fiseve malorë të egër, me një nivel kulturor shumë të ulët, mund të krijohet një rend i sigurt për të ardhmen, për mirëzhvillimin e të cilit Monarkia ka bërë dhe do të bëjë sakrificat më të mëdha. Vetëm me anë të aneksimit do të kemi mundësi të zhdukim dhe t'i bëjmë të padëmshme ndikimet e shumëllojshme dhe opinionin jo miqësor të Bullgarisë, të Greqisë dhe të Italisë, kundër të cilëve ne kemi pas luftuar, madje po luftojmë edhe tani gjatë okupacionit dhe administrimit tonë. Në bazë të shënimeve të mësipërme mbi gjendjen reale, të cilat burojnë nga bindja ime e plotë, apeloj në Shkëlqesinë tuaj [ministër të Punëve të Jashtme], duke ju lutur të hiqni dorë nga ideja e krijimit të një shteti shqiptar të pavarur dhe zgjidhja e problemit shqiptar të bëhet në marrëveshje me Bullgarinë dhe në rast nevojë edhe me Greqinë”¹.

Ky ishte opinionin qartazi i artikuluar, që komandanti i Përgjithshëm i Korpusit të 19 të ushtrisë austro-hungarez në Teshen kishte për shqiptarët dhe Shqipërinë në pranverë të vitit 1916, vetëm tre muaj pasi ushtria

¹ *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: HHSt.A.P.A.A), në *Arkivin e Institutit të Historisë-Tiranë* (më tej: AIH), Vj. 26-17-1727, Raport i komandantit të Përgjithshëm të Distriktit të 19-të në Teshen për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, 18 prill 1916.

austro-hungareze kishte pushtuar pjesën më të madhe të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Krahas këtij opinioni ekzistonte edhe një tjetër krejt i kundërt me të, ai i diplomatit të karrierës August Ritter von Kral, njohës shumë i mirë i shqiptarëve dhe i Shqipërisë, ish konsull i Austro-Hungarisë në Shkodër e Manastir, përfaqësues i saj në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, që prej 12 prillit 1916 në detyrën e përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri². Për të: “Shqipëria nuk është një vend që ushqen ndjenja armiqësore kundër nesh. Shumica dërmuese e popullsisë kudo na pret me besim dhe gatishmëri. Pas vuajtjeve shumëvjeçare Shqipëria nuk kërkon gjë tjetër veçse rregull dhe qetësi. Me pak organizim, me një sjellje të arsyeshme dhe të drejtë, duke përdorur natyrisht rreptësinë aty ku është nevoja, vendi nën okupacionin tonë nuk është shumë zor të qeveriset”³.

Por këto dy opinione nuk ishin thjesht dy qasje të kundërta me njëra tjetrën, që vinin nga terreni. Ato përfaqësonin shumë më shumë se kaq. Ishin dy linja politike të dy prej institucioneve më të rëndësishme austro-hungareze, të Ushtrisë dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme: Nëse duhej konsideruar Shqipëria një vend i pushtuar dhe shqiptarët të trajtoheshin me ashpërsi dhe brutalitet të veçantë sepse ishin kundërshtarë, mosbesues dhe të pabindur, sikurse pretendonin autoritetet e larta ushtarake austro-hungareze? Apo, Shqipëria meritonte një tjetër trajtim, më miqësor dhe paqësor, sepse ishte një vend neutral, thuajse aleat, me një shumicë të popullsisë të lidhur besnikërisht me Austro-Hungarinë, sikurse mendonin diplomatët e lartë vjenezë, gjithmonë në dobi të sigurimit dhe zgjerimit të influencës politike, ekonomike e kulturore austro-hungareze mbi vendin e vogël kufitar, në brigjet e Adriatikut?⁴

² Për më shumë në lidhje me veprimtarinë e August Kral-it shih: Kurt Gostentschnigg, “August Ritter von Kral. Aktori kryesor i Austro-Hungarisë në trojet shqiptare”, në *Studime historike*, nr. 3-4, 2016, Tiranë: 2017, f. 49-71.

³ HHSt.A.PA.A, në *AIH*, Vj. 26-18-1899, Raport i administratës ushtarake në Teshen për kryekomandën e ushtrisë imperiale dhe mbretërore austro-hungareze, Teshen, 17 prill 1916.

⁴ Lidhur me këto dy rryma shih Fried, Marvin Benjamin, *Austro-Hungarian War Aims in the Balkans during World War I*, Basingstoke, New York: Palgrave Macmillan, 2014.

Ushtarakët përballë diplomatëve: Pikëpamjet e kundërta për Shqipërinë

Mosmarrëveshjet ndërmjet palës ushtarake dhe asaj diplomatike në lidhje me statusin që do të kishte Shqipëria dhe trajtimin që do të duhej të merrnin shqiptarët, e kishin zanafillën herët, të paktën që në vitin 1906. Në qendër të këtyre mosmarrëveshjeve qëndronte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Franz Conrad von Hötzendorf, i cili kishte tendencën që çështjet mirëfilli ushtarake t'i shikonte në kontekstin e politikës së jashtme. Sipas tij, të gjithë shtetet e vegjël ballkanikë, përfshirë edhe Shqipërinë, nuk duhej të ekzistonin dhe territoret e tyre duhej t'i bashkoheshin njësisë territoriale të Perandorisë Dualiste. Madje, në vitin 1908, në prag të aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës, shefi i Shtabit të Përgjithshëm propozoi që dy kundërshtarët më të rrezikshëm të shtetit dualist, Serbia dhe Mali i Zi të neutralizoheshin ushtarakisht dhe në këtë proces të merrnin pjesë edhe trupa vullnetare shqiptare. Pavarësisht se propozimi i tij u kundërshtua nga Ministria e Punëve të Jashtme (Ballhausplatz), Conrad von Hötzendorf dërgoi në viset veriore shqiptare edhe oficerë zbulimi, të cilët kishin si detyrë të përgatisnin raporte, të fokusuara kryesisht mbi interesa ushtarake⁵.

Edhe pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i qëndroi konsekuent qëndrimeve të tij në lidhje me Shqipërinë. Më 7 janar 1916 në mbledhjen e posaçme të Këshillit të Përbashkët Ministror, ku u diskutua për synimet strategjike të Perandorisë Austro-Hungareze në Ballkan, shefi i Shtabit të Përgjithshëm shprehu bindjen e vazhdueshme se aneksimi i territoreve shqiptare ishte rruga e duhur për të mbrojtur interesat e Monarkisë Dualiste në Ballkan. Eliminimin e shtetit të pavarur shqiptar, ai e argumentoi me mungesën e homogjenitetit të popullsisë vendase, si në lidhje me gjuhën, origjinën dhe fenë. Sipas tij, një shtet shqiptar "do të bëhet fushë përballjesh të

⁵ Shih: Wolfram Dornik, "Conrad von Hötzendorf and the "Smoking Gun": A bibliographical examination of responsibility and traditions of violence against civilians in the Habsburg Army", *Austro-Hungary, the origins and the first year of the World War I, Contemporary Austrian Studies/* vol. 23, Innsbruck University Press, 2014, p. 55-77; Graydon A. Tunstall, Jr, "Austria-Hungary", *The origins of World War I*, edited by Richard F. Hamilton, Holger H. Herwia, Cambridge University Press, 2003, p. 121-122; Franz Graf Conrad von Hötzendorf në <http://www.austro-hungarian-army.co.uk/biog/conrad.htm> (material i konsultuar më 27 tetor 2016).

shteteve të interesuara, sikundër në kohën e principatës [së Vilhelm Wied-it], para së gjithash të Italisë, të cilën nuk mund ta lejojmë që të vendoset përgjithmonë në bregun lindor të Adriatikut.... Por ky pikësynim nuk mund të arrihet pa bashkëpunimin e Bullgarisë dhe të Greqisë”⁶. Me këtë skemë, projekti i shefit të Shtabit të Përgjithshëm mbështeste aneksimin e Shqipërisë së Veriut deri në lumin Mat nga Austro-Hungaria, Shqipëria e Jugut i jepej Greqisë, ndërsa ajo e Mesme përfshirë edhe Durrësin i kalonte Bullgarisë⁷.

Në dallim, Ministria vjeneze e Punëve të Jashtme nuk e shikonte kaq të thjeshtë zgjidhjen e problemit shqiptar⁸. Për vite me radhë, ajo ishte angazhuar plotësisht në dobi të emancipimit kulturor dhe politik të shqiptarëve⁹ dhe më vonë, pas Shpalljes së Pavarësisë, në debatin mbi

⁶ *AIH*, A-IV-239, “Memorandum i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Austro-Hungareze dërguar kryeministrit hungarez”, fl. 25.

⁷ *Po aty*.

⁸ Çështja shqiptare dhe Shqipëria ishin pjesë e rëndësishme e programit politik dhe strategjik të Ministrisë Vjeneze të Punëve të Jashtme. Pozicioni gjeografik i territoreve shqiptare, në bregun lindor të Adriatikut, më pak se 60 milje larg bregdetit italian, e bënte Shqipërinë një *zonë tampon* për Austro-Hungarinë, e cila nuk dëshironte të kishte një shtet-satelit rus, të vendosur në këto brigje. Krijimi i një shteti shqiptar pengonte zgjerimin tokësor të fqinjëve sllavë deri në Adriatik. Në këndvështrimin austro-hungarez, Shqipëria së bashku me Bosnje-Hercegovinën dhe Greqinë, krijonte kordonin antisllav në Ballkan. Interesi i Monarkisë Dualiste ndaj çështjes shqiptare lidhej edhe me popullsinë katolike në Veri, ndaj së cilës ushtrohej e drejta e Protektoratit të Kultit. Nga ana tjetër, duke mbështetur shqiptarët, Vjena zgjeronte ndikimin e saj politik, ekonomik e kulturor në viset shqiptare, fillimisht si pjesë e Perandorisë Osmane dhe më vonë si shtet i pavarur, duke balancuar, madje shmangur, influencën italiane aty.

Shih: Kurt Gostentschnigg, “Kontributi i Austrisë (Austro-Hungarisë) për Shqipërinë e Veriut në fushën e arsimit”, në *Shkodra në shekuj*, Seminari i Pestë Ndërkombëtar (25-26 tetor 2002), Shkodër: Rozafa 01, 2005, f. 168-174; Ledia Dushku, “Qëndrimi i Austro-Hungarisë për çështjen e kufirit shqiptaro-grek 1912-1913”, në *Shqipëria-Austria: reflektim historiografik* (Aktet e Konferencave Shkencore Ndërkombëtare: Shkodër, maj 2012-Tiranë, tetor 2012) Tiranë: Botimet Albanologjike, 2013, f. 115-124.

⁹ Shtyllat kryesore të angazhimit austro-hungarez kishin të bënin me kujdesin dhe stimulimin e gjuhës e të letërsisë shqipe, me përhapjen dhe zhvillimin e institucioneve kulturore e fetare katolike dhe me zgjerimin e lidhjeve ekonomike. Në funksion të kësaj politike në vitin 1896 Austro-Hungaria filloi të realizonte të ashtuquajturin “Aksion në Shqipëri”. Qëllimi kryesor nuk ishte pushtimi i

statusin ndërkombëtar, përcaktimin e kufijve të saj dhe organizimin e shtetit të ri¹⁰. Ministri austro-hungarez i Punëve të Jashtme, Stephan Burián von Rajecz, në fillim të janarit 1916, në mbledhjen e posaçme të Këshillit të Përbashkët Ministror mbështeti idenë që jo vetëm të ruhej pavarësia e Shqipërisë, por asaj t'i bashkoheshin përsëri ato krahina, të cilat pas Luftës së Parë Ballkanike u ishin dhënë Serbisë e Malit të Zi.

“Ne nuk duhet të rrëmbelemi nga tentativa e parë që dështoi dhe të mos krijojmë një Shqipëri të pavarur. Shqiptarët gjithmonë e kanë treguar vullnetin se duan të ekzistojnë dhe e kanë vënë në zbatim me këmbënguljen më të madhe. Fakti që raca e tyre, me gjithë copëtimin nacional dhe sundimin e tmerrshëm dhe arbitrar [osman], mundi të ruajë tiparet e saj, të trashëguara prej kohëve të vjetra, dëshmon aftësinë kombëtare të shqiptarëve. Nuk duhet harruar se, vendi pas marrjes së vendimeve të Londrës nuk ka pasur asnjë çast mundësinë që të qëndrojë me këmbët e veta. Atë kohë organizimi u bë sipas metodave krejt të gabuara, të përshtatshme për një vend evropian, me kulturë. Shtetit të ri iu dhanë instruksione krejt të tepërta dhe u la mbas dore gjëja më e rëndësishme, d.m.th. organizimi politik i popullit nga poshtë-lart, në bazë të institucioneve ekzistuese, që mbështeteshin në zakonet e vjetra. Si rrjedhim i marrëveshjeve tona me Italinë atje u zhvillua një kondominium i dy Fuqive të Adriatikut, që rezultoi fatal për vendin. Madje, Italia qysh ditën e parë ndoqi vetëm qëllimet e saj”. Shteti shqiptar, shtoi ministri i Jashtëm, mund të zhvillohet fare mirë po të udhëhiqet drejt dhe “këtë punë duhet ta bëjmë ne, duke ushtruar një protektorat efektiv mbi Shqipërinë, jo me qëllim që ta aneksojmë, por nisur nga dëshira për ta bërë të qëndrojë me këmbët e veta dhe për ta

Shqipërisë, por në rast të shpërbërjes së Perandorisë Osmane, të mbështetej ngritja e një Shqipërie autonome ose të pavarur, me një princ të huaj, nën protektoratin austro-hungarez. Në vija të përgjithshme “Aksioni në Shqipëri” konsistonte në kontaktimin e shqiptarëve me influencë, në mënyrë që ata të punonin për rritjen e ndërgjegjes kombëtare në vend, dhe rrjedhimisht të ndikonin në rritjen e reputacionit të Perandorisë Dualiste në Shqipëri. Ky aksion parashihte edhe masa të tjera që kishin të bënin me përmirësimin e aparatit kishtar, të shkollave dhe propagandës kulturore. Shih: K. Gostentschnigg, “Kontributi i Austrisë (Austro-Hungarisë) për Shqipërinë e Veriut ...”, f. 168-174; K. Gostentschnigg, Karl Kaser “Albanologjia austro-hungareze 1867-1918-një rast i imperializmit kulturor? Një projekt shkencor”, në *Hylli i Dritës*, nr. 1-2/2014, Vjeti XXXIV, Shkodër, f. 3-27.

¹⁰ L. Dushku, “Qëndrimi i Austro-Hungarisë për çështjen e kufirit shqiptaro-grek...”, f. 115-124.

mbrojtur para çdo ndërhyrjeje të një të treti ... domethënë të themelojmë dhe të konsolidojmë pavarësinë e një shteti, i cili, në përputhje me interesat e tij jetike, t'u shërbejë interesave tona në Ballkan"¹¹.

Burian-i ishte me këmbë në tokë dhe i ndërgjegjshëm se realizimi i pavarësisë shqiptare nën protektoratin austro-hungarez do të varej nga përfundimi i Luftës së Madhe dhe se, Italia nuk do të hiqte dorë vullnetarisht nga pozita e saj në bregun lindor të Adriatikut. Në këtë rast, ministri i Jashtëm, krahas protektoratit të Shqipërisë, u paraqiti kolegëve të tij në Këshillin e Përbashkët të Ministrave, edhe një alternativë tjetër. Kjo alternativë, e cila kishte të bënte me ndarjen e Shqipërisë, thuhet se shkonte në të njëjtën linjë me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralit Franz Conrad von Hötzendorf. Austro-Hungaria do të aneksonte pjesën veriore të Shqipërisë, ndërsa Greqia dhe Bullgaria do të ishin dy shtetet e tjera që do të shpërbleheshin me toka shqiptare. E para, sepse asaj i ishte premtuar që në rast se qëndronte neutrale, Vjena nuk do të kundërshtonte aneksimin e Shqipërisë Jugore prej saj. Ndaj pretendimeve bullgare, Burian-i ishte i rezervuar dhe, në dallim nga Conrad, sugjeronte që ato të mos inkurajoheshin në drejtim të Perëndimit¹².

Thuhet se të njëjtin qëndrim me shefin e diplomacisë kishin edhe kryeministri i Hungarisë, István Tisza dhe ai i Austrisë, Karl Graf von Stürgkh. Sa i përket mundësisë së zhvillimit të Shqipërisë në të ardhmen, konti Tisza shprehej më pak optimist se ministri Burian. Sipas tij, ndërhyrja austro-hungareze në Shqipëri duhej të ishte shumë e kufizuar. Shteti dualist nuk duhej të bënte prova për ta transformuar Shqipërinë në një vend evropian të kulturuar, sepse çdo dështim që mund të pasonte do të konsiderohej si disfatë e Monarkisë. "*Secili të shkojë në parajsë sipas mënyrës së tij*"¹³ - shprehej ai. Gjithashtu, kryeministri hungarez, me të drejtë, nuk e konsideronte të lehtë mundësinë që Austro-Hungaria të mbante larg Shqipërisë influencat e huaja, veçanërisht ato italiane. Sipas tij, vendi ishte i përçarë në disa parti dhe, shqiptarët gjatë luftërave të

¹¹ *AIH*, A-IV-239, "Protokolle të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave të Përbashkët të Monarkisë Austro-Hungareze (Protokolle der Ministerratssitzungen Österreich-Ungarns) (1914-1918)", fl. 12-13. Protokollin e mbledhjes së datës 7 janar 1916.

¹² *Po aty*, fl. 13.

¹³ *Po aty*, fl. 14, Protokollin e mbledhjes së datës 7 janar 1916.

partive të tyre, do të ishin gjithmonë të gatshëm të pranonin ndihmë të huaj, madje edhe ar. Megjithatë, pavarësisht dyshimeve, konti Tisza konkludonte se “është më mirë për ta përsëritur edhe një herë provën me një Shqipëri të pavarur dhe vetëm kur ajo të dështojë, të mendojmë për një zgjidhje tjetër. Me këtë rast, në radhë të parë, do të vinte në konsideratë bashkimi i saj me Greqinë”¹⁴.

Në dallim nga kryeministri hungarez, homologu austriak ishte më skeptik lidhur me mundësinë e organizimit të vendit si shtet i pavarur, sepse eksperiencat e deriatëhershme nuk ishin aspak inkurajuese. Ai binte dakord me kontin Tisza në lidhje me rrezikun e madh të intrigave të huaja, ku veçoheshin ato italiane. Në këto kushte protektorati sa më efektiv i mundshëm, konsiderohej i vetmi mjet që mund t’i bënte ballë¹⁵.

Mosmarrëveshjet midis diplomatëve dhe ushtarakëve nuk u fashitën në mbledhjen e 7 janarit 1916. Përkundrazi, ato vazhduan me po të njëjtat argumente, deri në dhjetor të po atij viti, ku asnjë palë nuk u tërhoq nga pozitat që mbronte, çka bëri që përballja mes tyre të kthehej më tepër në një betejë prestigji dhe protagonizmi¹⁶.

Shqiptarët përballë mosmarrëveshjeve mes ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë

Në janar 1916, komanda e Armatës së Tretë e ushtrisë austro-hungareze u urdhërua të fillonte përgatitjet për dërgimin e një detashmenti të përforcuar në rajonin jugor të liqenit të Shkodrës. Vendimi për të hyrë ushtarakisht në Shqipëri u mor në kushtet e operacionit strategjiko-operativ, ndaj Serbisë dhe Malit të Zi. Synimi kryesor i komandës austro-hungareze ishte marrja e portit të Shëngjinit, për të

¹⁴ *Po aty*, fl. 15, Protokoll i mbledhjes së datës 7 janar 1916.

¹⁵ *Po aty*, fl. 19, Protokoll i mbledhjes së datës 7 janar 1916.

¹⁶ Për më shumë në lidhje me përplasjen në vijim midis Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ushtrisë Austro-Hungareze shih: Helmut Schwanke, *Zur Geschichte der österreichisch-ungarischen Militärverwaltung in Albanien (1916-1918)*, Tezë doktore, mbrojtur në vitin 1982; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë, vëll. I (1912-1939)*, Tiranë: Botimet Toena, 2013, f. 284-286; Kurt Gostentschnigg, “The different researcher types. Austro-Hungarian Albanology between Politics and Military”, kumtesë mbajtur në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë *Marrëdhëniet e popullit shqiptar me Austro-Hungarinë (Austriën), nga mesi i shek. XIX deri në ditët tona*, Prishtinë, më 9 shtator 2016 (në proces botimi).

penguar largimin nga deti të ushtrisë serbe, tashmë të shpartalluar nga trupat austro-hungareze. Pas dorëzimit të ushtrisë malazeze, detashmenti austro-hungarez i Armatës së Tretë, nën komandën e nënkolonelit Kramer hyri pa luftë, më 23 janar 1916 në qytetin e Shkodrës. Shtabi i Korpusit të 19-të mbërriti në Shkodër më 11 shkurt të po atij viti¹⁷.

Pikëpamjet e kundërta që ushtarakët dhe diplomatët austro-hungarezë kishin në lidhje me Shqipërinë u reflektuan menjëherë në terren. Përsa kohë që violinë e parë në administrimin e territoreve shqiptare mbeteshin autoritetet e larta ushtarake, shpërthimi i një ndjenjeje zemërimi e pakënaqësie të shqiptarëve karshi politikës që po ndiqej ndaj tyre, ishte i pashmangshëm.

Përgjatë gjysmës së parë të vitit 1916, pakënaqësia preku shtresa dhe kategori të ndryshme të shoqërisë shqiptare. Politika e ndjekur nga administrata ushtarake dhe moskuptimi nga ana e saj i marrëdhënieve të Ministrisë së Punëve të Jashtme austro-hungareze me shqiptarët solli shtrëngesa të vazhdueshme dhe shpeshherë të pamëshirshme, edhe pse në kushte lufte. Të tilla ishin rekuizimet e kafshëve bartëse dhe të parmendës veçanërisht në zonat malore¹⁸, detyrimi i popullsisë për të paguar me flori blerjen e drithit dhe të produkteve ushqimore, dëmtimi i interesave të tregtarëve në rastet e blerjes nga ushtria të produkteve të

¹⁷ Marenglen Kasmi, “Shqipëria ‘austriake’ dhe komitet që paguheshin me flori”, në gazetën *Dita*, 13 shkurt 2016; Beryl Nicholson, “On the front line in someone else’s war: Mallakastër Albania, 1916-1918”, në *Religion: Regional Studies of Russia, Eastern Europe and Central Asia*, vol. 4, no. 2, 2015, f. 248.

¹⁸ Në letrën që imzot Bumçi, ipeshkv i Lezhës, i dërgoi konsullit Kral, më 19 prill 1916, krahas sjelljes së pahijshme të ushtarëve kundrejt malësorëve të rrethinave të Lezhës e të Bregut të Matës, evidentoi edhe zemërimin e tyre për shkak të rekuizimit të bagëtive nga ana e ushtrisë. Uria dhe dëshpërimi konsideroheshin prej tij si “këshilltarë të këqij”, të cilët mund t’i hidhnin malësorët në prehrin e propagandës. Në letër Imzot Bumçi nuk hezitonte të shkruante se: “Populli, i cili nuk i kupton vuajtjet e ushtarit në luftë, e nuk i mbushet mendja se komunikacioni i vështirë në kushtet e luftës, ndalon furnizimin e trupave me ushqime dhe detyron kryerjen e rekuizimeve, mbetet i pakënaqur dhe jo rrallë herë na takon të dëgjojmë të thotë: Kjo është Austria që na keni folur kaq tepër? Ju siguroj zoti konsull, se gjithë simpatia e popullit për qeverinë e shkëlqyer austro-hungareze është shndërruar në antipati, për të mos thënë në urrejtje, sepse tjetër qe ideja që ishte formuar mbi Austro-Hungarinë, e tjetër realiteti që po i shoqëron”. Shih: HHSt.A.PA.A në *AIH*, Vj. 26-15-1533, Letër e imzot Bumçit dërguar konsullit Kral, Kallmet, 19 prill 1916.

ndryshme të vendit, ndalimi i eksportit privat të këtyre të fundit, zbatimi i një varg masash të ashpra me rastin e rekrutimit të detyrueshëm dhe trajtimit ushtarak të shqiptarëve¹⁹, pa anashkaluar edhe qëndrimin aspak miqësor që administrata ushtarake mbajti ndaj ankimeve të popullsisë, të cilat sipas komandës së Korpusit të 19 që në mars të 1916-ës kishin marrë formën e një lumi që vazhdimisht vinte duke u fryrë²⁰. Vetëm disa muaj pas pushtimit, situata në terren ishte bërë aq shqetësuese sa zyra e komandës ushtarake në Elbasan arrinte në përfundimin se “nëse në kohën e okupimit popullsia kishte shpresa të mëdha tek regjimi ynë, ndaj të cilit priste gjëra krejt të ndryshme nga ato të qeverive ballkanike, tani ajo shprehet e zhgënjyer. Administrata jonë cilësohet si e keqe, madje po fillon të përhapet parulla se ajo është edhe më e keqe se ajo e Turqisë”.²¹

Mungesa e konsideratës së autoriteteve ushtarake austro-hungareze për veçoritë nacionale dhe fetare të vendasve, ishte një tjetër aspekt i dhunës formale që solli rritjen e zemëratës së shqiptarëve. Nga relacionet që vinin nga terreni raportoheshin vazhdimisht rastet, ku oficerët me kombësi sllave tentonin t’u përdhosnin shqiptarëve zakonet dhe veçoritë kombëtare. Në këtë drejtim vëmë në dukje edhe masat që u morën në Shkodër për të krijuar kopshte ditore për djemtë në moshën 8 vjeç e lart, apo strehimin e ushtarëve austro-hungarezë në shtëpitë e shqiptarëve myslimanë, çka preku ndjenjat e tyre në lidhje me pozitën e gruas²². Të mbledhur në xhaminë “Plakë”, përfaqësuesit e popullsisë myslimane në Shkodër, i dërguan një lutje konsullit Kral, me anë të së cilës, pa mohuar

¹⁹ HHSt.A.PA.A në *AIH*, Vj. 26-18-1856, Raport i konsullit të Përgjithshëm Kral për ministrin e Punëve të Jashtme, Shkodër, 27 mars 1916; *po aty*, Vj. 26-15-1527, Raport i konsullit të Përgjithshëm Kral për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, kontin Burian, Shkodër, 18 prill 1916; *po aty*, Vj. 26-15-1543, Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme, Burian për konsullin Kral, Vjenë, 8 maj 1916; *po aty*, Vj. 26-17-1735, Njoftim i kontit Burian, për përfaqësuesin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në ushtrinë austro-hungareze në Teshen, kontin Thurn, Vjenë, 15 maj 1916.

²⁰ *Po aty*, Vj. 26-18-1861, Komanda e korpusit të 19 për konsullin e Përgjithshëm Kral në Shkodër, posta fushore, 27 mars 1916.

²¹ *Po aty*, Vj. 26-19-1921, Raport i zyrës së komandës austro-hungareze në Elbasan dërguar komandës së divizionit të këmbësisë, Elbasan, 3 qershor 1916.

²² *Po aty*, Vj. 26-15-1527, Raport i konsullit të Përgjithshëm Kral për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Burian, Shkodër, 18 prill 1916; *po aty*, Vj. 26-17-1735, Njoftim i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për kontin Thurn, Vjenë, 15 maj 1916.

respektin për Madhërinë e tij Perandorin austro-hungarez, kundërshtonin masat e marra nga komanda ushtarake²³. Sipas tyre, parimet e besimit mysliman kishin ngritur “një mur ndarës” midis burrave dhe grave, çka i bënte ata të mos i prisnin trupat ushtarake në shtëpitë e tyre. Duke e pasur të vështirë të hiqnin dorë nga superioriteti që kishin patur në sistemin e milletit, ata e konsideronin të parakohshëm edhe vendimin e ushtarakëve për t’i detyruar shqiptarët myslimanë të rekrutuar në ushtri, që të zhvillonin gjimnastikë dhe ushtrime ushtarake, së bashku me të tjerët. Ndonëse kjo justifikohet me pafuqinë fizike për shkak të zisë së bukës, ai mund të konsiderohet si një gjest krenarie karshi komuniteteve të tjera fetare.

Edhe procesi i çarmatimit, aq shumë i domosdoshëm, dështoi në momentin kur u shndërrua në një proces të dhunshëm. Çarmatimi i përgjithshëm i popullsisë u urdhërua në prill 1916 dhe, në zbatim të tij, filloi menjëherë kontrolli për armë. Ata që kishin armë të fshehura dhe nuk respektonin afatet e dorëzimit, gjobiteshin, arrestoheshin ose internoheshin²⁴. Ndonëse personalitete me emër, siç ishte rasti i Syrja Vlorës, këshillonin për kryerjen e çarmatimeve me takt të madh, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lokale²⁵, procesi nuk rezultoi aspak i

²³ *Po aty*, Vj. 26-17-1776, Lutje e përfaqësuesve të popullsisë myslimane të Shkodrës dërguar konsullit Kral, Shkodër, 24 prill 1916.

²⁴ Procesi i çarmatimit përfshiu edhe shqiptarët në Mal të Zi dhe Kosovë. Për mosbindje ndaj këtij procesi dhe mosrespektim të afateve të dorëzimit të armëve, shumë shqiptarë në Tuz u arrestuan, të tjerë në Podgoricë u internuan, ndërsa në Pejë u ekzekutuan, sipas një procedure gjyqësore të rregullt, në mbështetje të Ligjit të Luftës. HHSt.A.P.A.A në *AIH*, Vj. 26-17-1799, Raport i përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Cetinë për ministrin, Burian, Cetinë, 8 tetor 1916.

²⁵ Në memorandumun dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, më 22 shkurt të 1916-ës, në lidhje me procesin e çarmatimit Syrja Vlora shprehej se: “Detyra e parë dhe më kryesore e administratës së re është çarmatimi në të gjithë vendin. Duke marrë parasysh se është fjala për qytete ose katunde të fushave dhe krahinave malore me privilegje shekullore, ai duhet bërë me takt të madh dhe duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e ndryshme lokale. Por në radhë të parë duhet kujdesur që të gjitha armët të depozitohen në depo dhe secili pronar arme të marrë një dëftesë zyrtare në të cilën të njihet e drejta e tij e pronësisë mbi armën e dorëzuar”. HHSt.A.P.A.A në *AIH*, Vj. 26-18-1819, Memorandum i Syrja Bej Vlorës dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vjenë, 22 shkurt 1916.

tillë. Pa marrë parasysh marrëdhëniet shekullore të shqiptarëve me armën, pa mundur të depërtonin në psikologjinë e popullsisë, si edhe duke i lënë vendasit pas dore dhe duke krijuar reparte të xhandarmërisë vetëm me ushtarë austriakë dhe hungarezë, autoritetet ushtarake përvijuan çarmatime të përgjakshme kryesisht në viset veriore²⁶. Veçohet aksioni i qershor-korrikut të 1916-ës në Lurë, ku megjithëse u vranë të paktën 44 persona u mblodhën vetëm 300 armë²⁷.

Shenja të pakënaqësisë u manifestuan edhe në rrethet nacionaliste shqiptare. Këto rrethe shpreheshin të pakënaqura me deklaratat jo oportune të oficerëve austro-hungarezë për ndarjen e Shqipërisë dhe bashkimin e viseve veriore me Monarkinë. “Detyra kryesore e ushtrisë austro-hungareze, shprehej Syrja Vlora në memorandumimin drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, më 22 shkurt të 1916-ës, duhet të jetë, të evitohet që ndër bashkëpatriotët e mi të ngjallet dyshimi se krijimi i një Shqipërie nacionale, aq shumë të dëshiruar prej tyre është në rrezik”²⁸. Përdorimi nga ushtarakët, i një gjuhe aspak politike karshi shqiptarëve, konsiderohej i qortueshëm edhe prej ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë. Për të “përdorimi i një gjuhe të tillë, jo vetëm që e largon prej nesh pjesën e popullsisë me ndjenja nacionaliste, por nxit të krishterët dhe myslimanët kundër njëri-tjetrit”. Shenja pakënaqësie u shfaqën edhe në pranverë të 1916-ës, kur autoritetet ushtarake austro-hungareze në bashkëpunim me ato bullgare, penguan mbajtjen e një kongresi kombëtar në Elbasan, duke përdorur si shkak rrezikun e përhapjes së epidemisë së kolerës.

Nuk duhet anashkaluar këtu edhe pakënaqësia e shkaktuar nga trajtimi politik i parisë shqiptare. Shpeshherë karshi saj nuk u veprua në

²⁶ Procese të përgjakshme çarmatimi u bënë edhe në Arni në Dibrën e Vogël apo Okshtun, afër Martaneshit. Në korrik 1916 në Okshtun, mbas një kontrolli që u bë në një shtëpi ku nuk u gjetën armë, pati një përleshje të armatosur mes shqiptarëve dhe reparteve austro-hungareze. Një ushtar austro-hungarez u plagos, disa shqiptarë u vranë dhe 20 të tjerë u internuan. HHSt.A.PA.A në *AIH*, Vj. 26-17-1793, Raport i konsullit Kral për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Shkodër, 17 shtator 1916.

²⁷ *Po aty*, Vj. 26-11-1194, Raport i konsullit Kral për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Shkodër, 14 korrik 1916; *po aty*, Vj. 26-17-1793, Raport i konsullit Kral për ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme, Shkodër, 17 shtator 1916.

²⁸ *Po aty*, Vj. 26-18-1819, Memorandum i Syrja Bej Vlorës dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vjenë, 22 shkurt 1916.

bazë të arsyeve të paanshme dhe të peshuara me kujdes, si në rastin e dënimeve (internime dhe konfiskime), të asaj pjese të parisë që manifestonte ndjenja italofile, ashtu edhe tek favorizimet në emërimet të pjesës filoaustrake²⁹.

Një ngjarje që nuk kaloi pa lënë gjurmë, veçanërisht në rrethet ushtarake shqiptare, ishte pushkatimi i katër oficerëve të batalionit VIII të vullnetarëve shqiptarë. Më 4 qershor 1916 u pushkatuan komandanti i batalionit, kapiten Kamber Ali Berati, dhe togerët Bexhet Riza Manastiri, Abaz Bej Elbasani, ndërsa më 15 qershor edhe togeri i katërt, Mahmut Shefiku³⁰. Ata u akuzuan për krim kundër fuqisë ushtarake sepse, nën ndikimin e propagandës italiane, kishin nxitur ushtarët të braktisnin pozicionet e tyre. Por, përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, konsulli Kral e konsideronte pa vend një akuzë të tillë. Sipas tij, të gjithë oficerët e pushkatuar nuk kishin pasur ndonjë lidhje me italianët, por kishin rënë në konflikt me oficerët austro-hungarezë për trajtimin e vullnetarëve shqiptarë. Kjo ngjarje, vijonte ai, ishte bërë shkak që ndër oficerët shqiptarë të dominonte zia dhe në shumë raste edhe zemërimi³¹.

Por rritja e pakënaqësisë dhe e zemërimit të shqiptarëve nuk ishte e vetmja rrjedhojë e politikës së ndjekur nga kryekomanda e ushtrisë ndaj shqiptarëve. Lulëzimi i propagandës kundër Austro-Hungarisë si brenda Bllokut Tripalësh ashtu dhe jashtë tij, ishte rrjedhoja e dytë. Gjendja në Shqipëri kishte zgjuar aspiratën e aleatëve të Austro-Hungarisë për të ndërhyrë në punët shqiptare. Nuk ka më dyshim, shprehej ministri i Punëve të Jashtme, konti Burian se “ne duhet t’i kundërshtojmë aspiratat e Turqisë dhe të Bullgarisë për ta bërë territorin shqiptar të okupuar prej nesh një arenë aspiratash të veçanta ...”³². Nga ana tjetër, në bllokun kundërshtar atë të Antantës, shtypi me kohë transmetonte lajme mbi pakënaqësinë e shqiptarëve dhe për përhapjen e një lëvizjeje kryengritëse

²⁹ *Po aty*, Vj. 26-19-1937, Njoftim nga Ministria e Punëve të Jashtme për zotin Vizner pranë kryekomandës së ushtrisë, Vjenë, 25 gusht 1916.

³⁰ *Po aty*, Vj. 26-15-1573, Raport i konsullit Kral për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Shkodër, 16 qershor 1916.

³¹ *Po aty*, Vj. 26-17-1793, Raport i konsullit Kral për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Shkodër, 17 shtator 1916.

³² *Po aty*, Vj. 26-12-1202, Njoftim i ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Burian për kontin Turn në Teshen, Vjenë, 16 tetor 1916.

në tokat shqiptare të okupuara prej austro-hungarezëve³³. Kështu, gjendja në terren po përdorej me efikasitet nga armikja e Austro-Hungarisë, Italia e cila po vinte në zbatim, pikërisht ato mjete aksioni që autoritetet ushtarake austro-hungareze nuk po i përdornin, të tilla si propagandimi i idesë së një Shqipërie autonome, e shoqëruar kjo me premtime dhe avantazhe materiale për popullsinë dhe rekrutët shqiptarë³⁴.

Situata shqetësuese në terren do ta detyronte ministrin e Punëve të Jashtme, të rriste presionin pranë autoriteteve ushtarake dhe t'i akuzonte ato se po hidhnin poshtë punën me dekada, bërë nga administratat konsullore austro-hungareze në viset shqiptare. Këtë punë, që zyrtarisht kishte konsistuar në veprimtarinë humaniste, përmirësimin e nivelit të arsimit dhe përhapjen e zhvillimit kombëtar ndër shqiptarë³⁵, konti Burian e konsideronte një fitore të gëzueshme të shërbimit të jashtëm, të caktuar për krijimin e një kapitali të çmuar për të ardhmen, por që “sot, shprehej ai - pjesërisht ka humbur dhe sipas njoftimeve është në rrezik që të zhduket fare”. Ai pohonte: “Kjo nuk është e dëmshme vetëm nga pikëpamja e politikës së jashtme, por edhe nga ajo ushtarake, mbasi në bazë të informatave të shumta zemërimi i shqiptarëve po merr

³³ *Po aty*, Vj. 26-19-1937, Njoftim nga Ministria e Punëve të Jashtme për zotin Vizner pranë kryekomandës së ushtrisë, Vjenë, 25 gusht 1916.

³⁴ *Po aty*. Vj. 26-12-1202, Njoftim i ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Burian për kontin Turn në Teshen, Vjenë, 16 tetor 1916. Konti Burian evidentonte se “... tani gjendemi para faktit se armiqve tanë në Shqipëri po u krijohen avantazhe efektive nga ajo që kryekomanda e ushtrisë i la pas dore një varg këshillash të këtij dikasteri, p.sh. propagandimin e idesë së një Shqipërie autonome, përkrahjen e rekrutimit të shqiptarëve me premtimin e avantazheve materiale, e të tjera si këto, ndërsa Italia përdor me të vërtetë, pikërisht të njëjtat mjete aksioni”. Ndërsa pak muaj më parë, në urdhëresën sekrete për kontin Turn, i dërguari i Ministrisë së Punëve të Jashtme pranë kryekomandës së ushtrisë austro-hungareze në Teshen, konti Burian kishte shprehur shqetësimin se “Italia shfrytëzon kundër nesh aspektin material. Formacionet tona shqiptare influencohen nga kjo mënyrë, aspak e favorshme për ne. Nga ana tjetër, shqiptarët që gjenden në shërbimin italian të luftës kanë përfitime materiale shumë të mëdha”.

Shih: *Po aty*. Vj. 26-11-1187, Urdhëresë sekrete e kontit Burian për kontin Turn, Vjenë, 15 qershor 1916.

³⁵ K. Gostentschnigg, “Qëndrimet e Austro-Hungarisë ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në kontekstin e marrëdhënieve të përgjithshme Austro-Shqiptare” në *Shqipëri-Austri reflektim historiografik*, Aktet e Konferencave Shkencore, Shkodër, maj 2012 & Tiranë, tetor 2012, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2013, f. 40.

dimensione kaq të mëdha, sa që nëse nuk merren masa të shpejta, duhet llogaritur që shqiptarët në një rast të favorshëm, do të marrin anën kundër nesh dhe në dobi të armiqve tanë”³⁶.

Në një situatë të tillë, përgjatë verës së 1916-ës u morën një varg masash që në thelb kishin uljen e pakënaqësisë dhe rifitimin e simpatisë së shqiptarëve. U synua evitimi i shtrëngesave të panevojshme, kryesisht ekonomike dhe ushtarake karshi shqiptarëve, shtrëngesa të cilat kishin ardhur si rezultat i politikës së ndjekur nga drejtuesit ushtarakë të administratës austro-hungareze në Shqipëri. Ditët e fundit të korrikut, komandanti i Përgjithshëm i distriktit të 19, koloneli Lustig, i konsideruar prej konsullit Kral si përgjegjës për politikën e ashpër karshi shqiptarëve³⁷, u transferua në frontin e Karintinisë dhe vendin e tij e zuri nënkoloneli Shatëll.

Masa e dytë kishte të bënte me zbatimin në Shqipëri të politikës së autonomisë kulturele-kombëtare që ndiqej kundrejt popujve të tjerë të Perandorisë Dualiste. Në këtë aspekt u vendos ushtrimi i kompetencave të komisarit civil të vendit pranë Komandës së Korpusit të 19. Kralit iu la dorë më e lirë në organizimin e administratës së përgjithshme, në fushën e financës, të drejtësisë dhe të arsimit. Vendimtare në këtë drejtim ishte kompetenca që iu akordua atij në emërimin e personelit të zyrave shqiptare, pavarësisht se të gjitha këto lëvizje do të duhej të merrnin miratimin e komandës ushtarake austro-hungareze.

Sipas skicës së përgatitur prej konsullit Kral, për mënyrën se si duhej të administroheshin territoret shqiptare, ndër 5 pikësynimet e administratës austro-hungareze në Shqipëri, dy prej tyre kishin të bënin me ngritjen kulturore të vendit dhe të popullsisë dhe me edukimin e shqiptarëve me vetëdije nacionale unike, për t'i bërë të aftë për vetëqeverimin e ardhshëm të vendit të tyre³⁸. Për realizimin e këtyre

³⁶ HHSt.A.PA.A në *AIH*, Vj. 26-19-1937, Njoftim nga Ministria e Punëve të Jashtme për zotin Vizner pranë kryekomandës së ushtrisë, Vjenë, 25 gusht 1916.

³⁷ *Po aty*, Vj. 26-19-1928. Njoftim i konsullit Kral për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Burian, Shkodër, 2 gusht 1916.

³⁸ Tre synimet e tjera të administratës austro-hungareze në Shqipëri kishin të bënin me sigurimin e operacioneve ushtarake, ruajtjen e interesave politike dhe ekonomike të Monarkisë, duke përjashtuar çdo influencë armike dhe sigurimin e jetës dhe të pasurisë. Shih: HHSt.A.PA.A në *AIH*, Vj. 26-18-1826, Njoftim i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për kontin Turn, Vjenë, 3 mars

pikësnyimeve, një rol vendimtar konsiderohej të kishte aspekti arsimor dhe pikërisht, kultivimi sa më mirë i gjuhës së vendit, përjashtimi i gjuhëve të huaja, sidomos i italishtes, evitimi i tentativave sllavizuese për gjuhën shqipe dhe shkollimi i të rinjve shqiptarë në shkollat dhe universitetet austro-hungareze³⁹.

Në zbatim të kësaj politike, në gusht të 1916-ës filloi rindërtimi i sistemit arsimor shqiptar nga ana e administratës ushtarake austro-hungareze. Objektivat kryesore ishin prodhimi i librave shkollorë në shqip, mënjanimi i gjuhës italiane dhe drejtimi i mësimin nga vendasit⁴⁰. Kështu erdhi në jetë Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit dhe tre drejtoritë arsimore në distriktet Shkodër, Tiranë dhe Berat. Personeli i Drejtorisë së Përgjithshme dhe drejtoritë e distrikteve përbëheshin kryesisht nga shqiptarët, gjithashtu edhe komisionet shkollore lokale të ngritura në shkolla, porse të gjitha vareshin nga komandat ushtarake përkatëse. Për përgatitjen e mësuesve të rinj dhe për kualifikimin e mësuesve ekzistues u projektua hapja e shkollave pedagogjike në Shkodër dhe në Elbasan⁴¹. Pritej që masat e marra të luanin rolin kryesor në përhapjen e ndjenjës kombëtare tek shqiptarët dhe të revokonin traditën e ndjekur nga Austro-Hungaria për mbështetjen e shqiptarëve në fushën arsimore dhe kulturore⁴².

Krahas Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit, me iniciativën e August Kral-it, miratuar me urdhrin e komandës së Korpusit të 19, më 30 qershor 1916 u themelua edhe Komisia Letrare Shqipe (KLSH), e cila e filloi veprimtarinë e saj, më 1 shtator.⁴³ Në përmbledhjen e dokumenteve të shpallura nga komanda e trupave austriake në Shqipëri, për krijimin e saj, thuhej se KLSH kishte si detyrë “t’i shërbejë organizimit arsimor të

1916. Transmetohet skicë-ideja e konsullit Kral për organizimin e territoreve shqiptare nën okupacionin austro-hungarez.

³⁹ *Po aty*.

⁴⁰ K. Gostentschnigg, “Kontributi i Austrisë (Austro-Hungarisë) për Shqipërinë e Veriut ...”, f. 172.

⁴¹ HHSSt.A.PA.A në *AIH*, Vj. 26-18-1805, Raport politik dhe administrativ i Komandës së Korpusit të 19 për Kryekomandën e Ushtrisë në Teshen, Shkodër, 16 tetor 1916.

⁴² Për më shumë në lidhje me rolin e Austro-Hungarisë në përhapjen e ndjenjës kombëtare shqiptare dhe të arsimit shqip shih: Kurt Gostentschnigg, “Kontributi i Austrisë (Austro-Hungarisë) për Shqipërinë e Veriut ...”, f. 168-174.

⁴³ K. Gostentschnigg, “Krali kundër Pekmezit – Lufta në Komisinë Letrare Shqipe në Shkodër 1916–1918” në *Shejzat* 1, nr. 3–4, Romë: 2016, f. 85–86.

ardhshëm dhe veçanërisht duhet të synojë t'i shërbejë zhvillimit të mëtejshëm nëpërmjet përmirësimit të gjuhës shqipe dhe njësimimit të drejtshkrimit, krijimit të fjalëve të reja, botimit dhe korrektimit të librave⁴⁴. Ajo kontrollonte në drejtim të një shprehjeje të njësuar dhe korrekte të gjitha dispozitat zyrtare të autoriteteve civile shqiptare dhe atyre ushtarake të huaja si dhe të gjitha publikimet zyrtare, librat shkollorë etj., përpara se këto të dilnin në botim. Në këtë mënyrë, krijimi i KLSH dhe vëmendja ndaj arsimit kombëtar mund të shërbenin edhe si një valvul e përkohshme shkarkimi e pakënaqësisë së një pjese të shqiptarëve karshi politikës austro-hungareze, pse jo edhe si një amortizator karshi depërtimit të propagandave të huaja antiaustriake, veçanërisht asaj italiane.

Kompromisi mes ushtarakëve dhe diplomatëve: Bisedimet e Teshenit

Ndërsa në Shqipëri, si rrjedhojë e masave të marra vërehej një zbutje e pakënaqësisë së shqiptarëve, diplomacia dhe ushtria të lodhur nga mosmarrëveshjet ranë dakord për t'u ulur në bisedime për të unifikuar qëndrimin karshi politikës që duhej të ndiqej në Shqipëri. Bisedimet, që u zhvilluan në Teshen, në selinë e Komandës së Përgjithshme, përfunduan më 9 dhjetor 1916 dhe prodhuan një kompromis midis dy qëndrimeve tashmë të njohura të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ushtrisë. Burian-i pranoi që autoriteti kryesor për të zbatuar politikën e Vjenës në kohën e luftës në Shqipëri do të ishte Komanda e Korpusit të 19-të të ushtrisë perandorake me seli në qytetin e Shkodrës. Komanda e Përgjithshme pranoi pikëpamjen e Ballhausplatz - it për ndërtimin në të ardhmen, në një kohë të pacaktuar një shtet shqiptar të pavarur nën protektoratin efektiv të Austro-Hungarisë, përmes një procesi edukimi të popullit shqiptar hap pas hapi nga administrata ushtarake⁴⁵. Në vazhdim të një procesi konsultimi që zgjati rreth një

⁴⁴ Tomor Osmani, *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918) dhe Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip (1879), Shoqëria "Bashkimi" (1899), Shoqëria "Agimi" (1901)*, Shkodër: Camaj-Pipa, 2009, f. 38.

⁴⁵ HHSt.A.P.A.A, në *AIH*, Vj. 12-1215, Raport i përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Alfred Rappapord dërguar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, 15 dhjetor 1916. Raportit i është bashkangjitur teksti i marrëveshjes së Teshenit; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 286.

muaj, u vendos që përmes një shpalljeje Komanda e Korpusit të 19-të t'u drejtohej shqiptarëve më 23 janar 1917, ditën e përvjetorit të hyrjes së trupave austro-hungareze në Shqipëri për t'u bërë të njohur synimet e politikës habsburgase⁴⁶.

Kompromisi mes ushtarakëve dhe diplomatëve qëndroi në këmbë deri në fund të vitit 1917, kohë kur komanda e Korpusit të 19 në Shkodër doli me propozimin për vendosjen në Shqipëri të një qeverie të përgjithshme ushtarake, siç ishte bërë edhe në Serbi. Ministria e Punëve të Jashtme, ashtu sikurse kishte ndodhur edhe më parë, i qëndroi konsekuente pikëpamjes së saj se Shqipëria ishte një vend neutral, thuajse aleat, me një shumicë të madhe të popullsisë të lidhur besnikërisht me Austro-Hungarinë. Si e tillë ajo meritonte të ishte autonome nën protektoratin efektiv të Monarkisë. Ndonëse kundërshtoi disa herë opinionet e ushtarakëve që këmbëngulnin se shqiptarët duhej të trajtoheshin më ashpër sepse ishin mosbesues, kundërshtarë e të pabindur, dhe propozimet e komandës së Korpusit të 19 në Shkodër për të vendosur në Shqipëri një regjim të hapur pushtimi⁴⁷, në shtator 1918, Ballhausplatz-i e ndjeu se fundi i luftës ishte i afërt dhe po kështu edhe fati i Perandorisë. Në këto kushte, ai iu nënshtrua Ministrisë së Luftës, duke pranuar se forma e protektoratit mbi Shqipërinë që kishte predikuar

⁴⁶ Pjesa e parë e Shpalljes evidentonte përputhshmërinë e interesave shqiptare me ato austro-hungareze, pa anashkaluar kontributet e Vjenës në të kaluarën në favor të tyre. Pjesa e dytë, i kushtohej premtimeve, ku radhiteshin përpjekjet e Austro-Hungarisë, që duke respektuar plotësisht besimin fetar, gjuhën, të drejtat dhe zakonet e trashëguara të shqiptarëve, t'i siguronte vendit një administratë të rregullt në interes të njerëzve, të sigurisë, nderit e pronës së tyre, si dhe të nxiste zhvillimin e ardhshëm kombëtar. Shqiptarëve u premtuhej se pasi të ishin mësuar së ushtruar sa më parë të drejtën e vetadministrimit, mbasi të ishin krijuar kushtet paraprake të autonomisë vendore, Austro-Hungaria do të ndërmernte menjëherë organizimin e vetadministrimit shqiptar. Shih: HHSt.A.PA.A, në *AIH*, Vj. 27-8.818, Projekti i Shpalljes dërguar August Kral-it nga Ministria e Punëve të Jashtme, Vjenë, 21 janar 1917; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 286-287.

⁴⁷ HHSt.A.PA.A, në *AIH*, Vj. 28-6-647, Deklaratë e Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me çështjen e vendosjes së një qeverie të përgjithshme ushtarake në Shqipëri, Vjenë, 17 janar 1918; *po aty*, Vj. 28-5-524, Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme për kryekomandantin e ushtrisë, gjeneralin Arc, Vjenë, 30 korrik 1918; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 288.

prej disa vjetësh do të varej ekskluzivisht prej përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe zhvillimit të bisedimeve të paqes⁴⁸.

S u m m a r y

ALBANIANS IN FRONT OF AUSTRO-HUNGARIAN MILITARY
OFFICERS AND DIPLOMATS
(1914-1916)

The disputes between the Austro-Hungarian military officers and diplomats originated from many years back, at least since 1906. At the very center of these disputes was the Chief of General Staff Franz Conrad von Hötzendorf. In his opinion all the small Balkan countries, including even Albania, shouldn't exist and their territories should be joining the Dual Monarchy.

With the outbreak of World War I the contradictions of two of the main Austro-Hungarian institutions, that is of the War Office and the Ministry of Foreign Affairs, immerged again: Was Albania to be considered as a conquered country and should Albanians be treated cruelly and especially brutally, because of being opponents, skeptic and disobedient just like the high military Austro-Hungarian authorities pretended? Or did Albania deserve another treatment, more benevolent and peaceful, because of being a neutral country, almost an ally, with a majority of population faithfully connected to Austria-Hungary as the high diplomats of Vienna thought?

The opposite viewpoints the Austro-Hungarian military officers and diplomats had regarding Albania and the treatment of Albanians was reflected in the field in the Austro-Hungarian territory of occupation. This article gives an answer to two basic questions: What was the influence of the confrontation between the military officers and diplomats in the policy followed by the Dual Monarchy toward the Albanians within the frame of World War I? What was the reaction of Albanians toward the policy followed by Austro-Hungarians towards them?

⁴⁸ HHSt.A.PA.A, në *AIH*, Vj. 28-2-232, Direktivat politike për administratën e Shqipërisë, Vjenë, 14 shtator 1918; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 289.